



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE

NIPT L71710039A

Nr.1004 Regj  
Nr. 5498 Prot

Tiranë, më 04.12.2019

URDHËR  
“PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”

Drejtuar: Qendra Kombetare e Biznesit  
Adresa: Tirane  
Per dijeni: “Grand Korca” Sh.p.k NIPT K24005001H  
Adresa: Korce, Ish Hotel Turizmi Iliria, (TEL.0682011491)  
Per dijeni: Inspektoriat Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut  
Adresa: Blv. “Deshmoret e Kombit”, Tirane,

Unë, Resul Alushani, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Zyres Permbarimore Private “REAL BAILIFF SERVICE”, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Vendimi Nr.1851, datë 18.10.2019 nga Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 1004, Datë 15.11.2019 kërkesën e kreditorit Inspektoriat Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut ndaj debitorit “Grand Korca” Sh.p.k NIPT K24005001H, në lidhje me titullin ekzekutiv “Vendimi Perfundimat Nr. 1438/2, datë 24.06.2019, i Inspektoriatit Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut”.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr. 5238 Prot, Datë 15.11.2019, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Vendimi Nr.1851, datë 18.10.2019, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA:

Debitori “Grand Korca” Sh.p.k NIPT K24005001H, nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të lajmërimit për ekzekutim vullnetar të detyrimit.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestro mbi kreditë e debitorit “Grand Korca” Sh.p.k NIPT K24005001H, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të nenit 527 e vijues të K.Pr.Civile, si dhe të Ligjit Nr. 26/2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”, me qellim ekzekutimin e titullit ekzekutiv,

URDHËROJ:

1. Qendra Kombetare e Biznesit, të vendose sekuestron konservative mbi aktivet e pales debitore “Grand Korca” Sh.p.k NIPT K24005001H, me qellim mostjetersimin tyre, si dhe mos kryerjen çdo veprimi që do të sillte ndryshime në regjistrin tregetar.
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
4. Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marja dijeni.

ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE “REAL BAILIFF SERVICE”  
PËRMBARUESI GJYQËSOR  
RESUL ALUSHANI

